

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-135/14

Prishtinë,  
27 janar 2016

Në çështjen juridike të:

**D.D.E.**

Rruga "Vasil Gorgov" 28/3-8  
Shkup  
IRJM

***Pala ankuese/Paraqitësja e kërkesës***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/223/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA17141), të datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 27 janar 2016, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e D.D.E. .
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/223/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin nr. KPA17141), i datës 27 nëntor 2013.

**Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike**

1. Më 28 shtator 2007 D.D.E. (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e të drejtës së saj të shfrytëzimit ndaj banesës nr.9, 43 Rruga “M.Tito” (ish rruga Car Dushani) në Suharekë me sipërfaqe prej 16,85 metra katrorë (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar). Në kërkesë nuk është përcaktuar data e humbjes së posedimit.
2. Pala ankuese ka theksuar në kërkesë se ajo ka shfrytëzuar pronën e kërkuar nga viti 1969 deri në vitin 1993 me familjen e saj dhe ajo kishte humbur posedimin në bazë të një vendimi të lëshuar nga Komuna e Suharekës për shkak se ajo kishte ndërruar vendin e saj të punës.
3. Për të mbështetur pretendimet e saj, pala ankuese në mes tjerash, ka dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
  - Kontratën mbi qiramarrjen, të datës 28 janar 1977 të lidhur në mes të Autoritetit për Banim të Suharekës dhe palës ankuese lidhur me pronën e kërkuar.
  - Vendimin e ndarjes nr. 373, të datës 08 dhjetor 1969, të lëshuar nga Bordi Ekzekutiv i Shtëpisë së Shëndetit në Suharekë përmes të cilit prona e kërkuar i ndahet palës ankuese. Në vendim ceket se nëse pala ankuese e humb punësimin e saj ajo gjithashtu do të humbë të drejtën e posedimit mbi pronën e kërkuar.
  - Vendimet mbi shumën e qerasë, të lëshuara nga Sekretariati i Drejtoratit për Banim, Shërbime Publike dhe Planifikim Urban në Suharekë më 08 nëntor 1990, 25 prill 1991 dhe 06 maj 1992.
  - Vendimin nr.360-1933/03, të datës 03.11.1993, të lëshuar nga Departamenti për Planifikim Urban, Shërbime Publike – Ndërtimtari dhe Çështje Banesore – Komuna e Suharekës, me të cilin pala ankuese ishte urdhëruar të lironte pronën e kërkuar.
  - Vendimin nr.360.01.360-424/93 të lëshuar më 13 dhjetor 1993 nga Ministria e Planifikimit Urban, Shërbime Publike dhe Rezidenciale dhe Ndërtimtari i Republikës së Serbisë, Qarku Kosovë, përmes të cilit shpallet si i pavlefshëm Vendimi i lartpërmendur i Departamentit për Planifikim Urban, Shërbime Publike, Ndërtimtari dhe Çështje Banesore – Komuna e Suharekës no.360-1933/03 i datës 03.11.1993 me anë të së cilit pala ankuese ishte urdhëruar të lironte pronën e kërkuar.
  - Vendimin e lëshuar nga Gjykata Komunale në Suharekë më 08.07.1994 me anë të së cilit pranohet kërkesa përfundimtare e Komunës së Suharekës dhe anulohet kontrata mbi shfrytëzimin e pronës së kërkuar e lidhur në mes të palës ankuese dhe Komunës së Suharekës. Pala ankuese urdhërohet të bartë posedimin mbi banesën te Komuna e Suharekës brenda 8 ditëve nga vendimi.

- Procesverbalin e datës 02.08.1993 që vërteton dorëzimin e pronës së kërkuar nga pala ankuese te Komuna e Suharekës.
4. Më 24 qershor 2009 Ekipi i AKP-së për Kryerjen e Njoftimit kishte bërë njoftimin e kërkesës. Prona e kërkuar ishte gjetur e zënë nga Sh.H. e cila nuk e kishte nënshkruar njoftimin mbi pjesëmarrjen.
  5. Pas njoftimit të pronës dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, askush nuk ishte paraqitur si palë përgjegjëse në kërkesë apo palë e interesuar para AKP/KKPK-së prandaj AKP/KKPK e trajtoi kërkesën e paraqitur si të pa-kontestuar.
  6. Bazuar në raportin e verifikimit të AKP-së të datës 29 maj 2012, kontrata mbi Qiramarrjen e datës 28 janar 1977 dhe Vendimi i lëshuar nga Gjykata Komunale në Suharekë më 08.07.1994 ishin verifikuar negativisht.
  7. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte kontaktuar palën ankuese më 24 shtator 2013 dhe ajo e kishte konfirmuar se ajo e kishte humbur posedimin mbi pronën e kërkuar në vitin 1993 për shkak të shpronësimit nga komuna.
  8. KKPK, me vendimin e saj KPCC/D/A/223/2013 të datës 27 nëntor 2013, kishte hedhur poshtë kërkesën për shkak të juridiksionit. KKPK vërtetoi se lënda nuk ka të bëjë me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999.
  9. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 26 shkurt 2014 dhe ajo kishte paraqitur ankesë më 26 mars 2014.

#### **Pretendimet e palës ankuese:**

10. Pala ankuese thekson se prona e kërkuar ishte konfiskuar në mënyrë të jashtëligjshme nga ajo sepse ajo e kishte shfrytëzuar banesën për një kohë të gjatë, mbi bazën e kontratës mbi shfrytëzimin dhe kishte paguar qeranë dhe obligimet e tjera me kohë. Ajo gjithashtu kishte paraqitur kërkesë për blerje por ajo ishte refuzuar.

#### **Arsyetimi ligjor**

#### **Pranueshmëria e ankesës**

11. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç përcaktohet me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale (në tekstin e mëtejshëm: Ligji 03/L-079).

#### **Meritat:**

12. Ankesa është e pabazuar..
13. Sipas nenit 3.1 të Ligjit 03/L-079, Komisioni ka kompetencën të zgjidhë kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtat që nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që ndërliken drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
14. Në rastin konkret, posedimi i pronës ishte humbur në vitin 1993 (vet pala ankuese e thekson këtë fakt), që do të thotë se kërkesa nuk ka të bëjë me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999. Prandaj, Komisioni me të drejtë e ka hedhur poshtë kërkesën sepse ajo është jashtë juridiksionit të saj.
15. Në bazë të arsyeve të përmendura dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit 03/L-079, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **Këshillë juridike**

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**